

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-082/2014

**Prishtinë
14 Prill 2016**

Në çështjen juridike të:

U.K.DOO

Përfaqësuar nga A.V.

Prishtinë

Pala ankuese

kundër

Rr.V.Gervalla, nr.1

Ferizaj

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetari i Kolegjit, Anders Cedhagen dhe Rolandus Bruin, anëtarë, lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/216/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13395), të datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 14 Prill 2016 mori këtë

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e vonuar ankesa e U.K. DOO nga Prishtina kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/216/2013, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA13395, të datës 21 gusht 2013.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 7 shtator 2006, M.R. në cilësinë e përfaqësuesit të subjektit juridik “U.K. Doo” (më tej: pala ankuese) paraqiti një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (më tej: AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së pronësisë, ri-posedimin dhe kompensimin për shfrytëzimin e paligjshëm të një hapësire të zyrave me sipërfaqe prej 54m², që ndodhet në rrugën Crnogorska nr.1 në Ferizaj (më tej: prona e kërkuar). Ai deklaroi se data e humbjes së pronës ishte 12 qershori 1999.
2. Njoftimi i kërkesës është kryer më 4 qershor 2007. Prona është gjetur e uzurpuar nga A.B. (më tej: pala përgjegjëse në ankesë), i cili ishte i pranishëm në pronë. Ai nuk pretendoi të drejtë ligjore mbi pronën dhe nuk e nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes. Ndonëse pala përgjegjëse në ankesë nuk shprehu interesim për procedurën, ai është konsideruar palë në procedurë.
3. Më 21 gusht 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tej: KKPK), përmes vendimit KPCC/D/C/216/2013 e refuzoi kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafi 37), KKPK-ja theksoi se pala ankuese nuk kishte arritur të paraqet ndonjë provë që ka mundur të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive, se bartësi i së drejtës mbi pronën e kërkuar i gëzon të gjitha të drejtat pronësore mbi pronën e kërkuar.
4. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 20 dhjetor 2013. I njëjti vendim iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 4 dhjetor 2013. Më 30 janar 2014, pala ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

Pretendimi i palës ankuese

5. Pala ankuese paraqiti ankesë përmes përfaqësuesit të tij Z. A.V. . Me ankesë pala ankuese kërkon që Gjykata Supreme e Kosovës ta ndryshojë vendimin e KKPK-së si të pabazuar dhe të paligjshme dhe ta pranojë kërkesën, si dhe t'ia njoh të drejtat pronësore të palës ankuese mbi pronën e kërkuar. Në ankesë, pala ankuese sugjeroi se vendimi i KKPK-së përmban gabim thelbësor dhe shkelje të rëndë të të drejtave materiale dhe procedurale, dhe se bazohet në vërtetim të gabuar dhe të mangët të gjendjes faktike. Pala ankuese shpjegoi se kërkesa bazohet në kontratën e lidhur ndërmjet Kuvendit Komunal të Ferizajit dhe “UK” DOO. Përmes kontratës, pala ankuese ka fituar pronësinë mbi pronën e kërkuar, që kurrë nuk është kontestuar.

Arsyetimi ligjor

6. Ankesa është e vonuar. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (më tej: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) parasheh si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditësh prej datës së njoftimit të palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës rreth vendimit të Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqes ankesë kundër atij vendimi përmes Sekretarisë Ekzekutive në Gjykatën Supreme të Kosovës”*.
7. Palës ankuese i është dorëzuar vendimi i KKPK-së më 20 dhjetor 2013 por ankesën e paraqiti vetëm më 30 janar 2014. Kjo do të thotë se ankesa është paraqitur jashtë afatit kohor të paraparë me ligj. Pala ankuese nuk ka dhënë arsye për paraqitjen e vonshme të ankesës dhe Gjykata Supreme nuk shih ndonjë arsye për vonesë.
8. Prandaj, ankesa u desh të hidhet poshtë si e papranueshme mbi baza procedurale dhe Gjykata Supreme nuk mundi t'i shqyrtojë bazat e paraqitura në ankesë.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky Aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetari i Kolegjit

Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it